



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORATI

Nr. 3634 prot.

Shkodër, më 28.10 .2019

**U R D H Ë R**

Nr. 334 datë 28.10 2019

**"PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT AD-HOC TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR BURSË PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", VKM-së nr.903, dt.21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" (i ndryshuar)

**Urdhëroj:**

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për trajtimin me bursë për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë.
2. Afati i aplikimit është nga data 28.10.2019-18.11.2019
3. Krijimin e komisionit AD-HOC të pranimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për trajtim me bursë për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë i përbërë nga:

Lindita Kastrati	kryetare
Enejda Dani	anëtare
Erard Çurçija	anëtar
Mimoza Kastrati	anëtare
Lidia Laca	anëtare
Suzana Lika	anëtare
Elton Shpuza	anëtar
4. Menjëherë me daljen e urdhrit specialisti i bursave znj.Saida Bizaku dorëzon tek kryetari i këtij komisioni me shkresë zyrtare listat e studentëve që kanë përfituar bursë vitin akademik 2018-2019.
5. Kryetari i komisionit koordinon punën dhe ngarkon me detyra specifike anëtarët e komisionit.
6. Komisioni mbledh aplikimet e studentëve të rregullt sipas afatit të sipërcituar në pikën 2 të këtij urdhri, harton relacionin shoqërues brenda 5 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit për aplikim.



7. Kryetari i komisionit harton materialet e nevojshme për konfirmimet përkatëse e miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit brenda 2 ditëve kalendarike nga konfirmimi i relacionit nga ana e administratorit.
8. Komisioni i pajisur me user-in për akses në portalin e –albania, do të gjenerojë nga portali e-Albania, dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e kërkesës për bursë të çdo aplikanti, pasi ky i fundit ka dhënë pëlqimin për administrimin e të dhënave personale.
9. Bashkëngjitur këtij urdhri Deklarata që duhet plotësuar nga studentit aplikant dhe nënshkruar nga specialisti që merr në dorëzim dokumentacionin përkatës si dhe njoftimi me dokumentet që duhen dorëzuar sipas përcaktimeve në VKM nr.903 datë dt.21.12.2016 (I ndryshuar).
10. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri komisioni.
11. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATORI**

**Eriklida Shpori**



**REKTORI**

**Prof. dr. Adem Bekteshi**



Konceptuan

Dr.Ekonomike Lindita Kastrati

Juristi Vilma Kojashi